



Kosovo Police 

1d · 

Sekuestrohen dy armë zjarri në dy raste të ndara arrestohen tre persona

Drejtoria Rajonale e Policisë – Prishtinë, po ndërmerr të gjitha masat e nevojshme policore për të siguruar rendin dhe qetësinë publike në rajonin e Prishtinës.

Në kuadër të veprimeve operative që po kryen policia me qëllim parandalimin dhe zbulimin e veprave kriminale, dje nga hetuesit e stacionit policor Veriu në Prishtinë dhe të stacionit të Lipjanit, në dy raste të ndara janë arrestuar tre persona të dyshuar.

Nga zyrtarët e stacionit të veriut është arrestuar personi i dyshuar:
B.,D, mashkull, 34 vjeç, për armëmbajtje pa leje, të cilit gjatë një kontrolli rutinor i janë gjetë dhe sekuestruar :

-një armë zjarri

- një karikatorë dhe

-2 fishekë.


Ndërsa nga zyrtarët e stacionit policor të Lipjanit, janë arrestuar dhe dërguar në qendër të mbajjtjes, personat e dyshuar:
-V.R, mashkull 39 vjeç,
-M.R, mashkull 61 vjeç, veprën Kanosje, që është raportuar dje rreth orës 16:00.

Përveç kanosjes ndaj personit M.R, mashkull 61 vjeç, është inicuar rast edhe për mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armës, pasi të njëjtit i është gjetë dhe sekuestruar:

- një pushkë gjuetie (leje të skaduar) dhe

- 4 fishekë.


See more of Kosovo Police on Facebook



Log In

or

Create new account



 99

1 comment

 Share